



**Njoftim nga takimi i kryetarit me drejtorët e komunës
Komuna merr vendim për rekrutimin e 20 nëpunësve të përkohshëm**

19 qershor 2012, Prizren

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Transparenca online e Komunës së Prizrenit" gjatë kësaj jave ka marrë pjesë në mbledhjen e radhës të kryetarit të komunës, Ramadan Muja me drejtorët komunal, ku janë miratuar disa konkluzione.

Ekzekutivi lokal me kërkesën e Drejtorisë së Administratës ka nxjerrë konkluzionin për lejimin e rekrutimit të njëzet nëpunësve për kryerje të shërbimeve të veçanta në Komunën e Prizrenit, për kohë të caktuar, pas kërkesës së disa drejtorive, për mungesë të kapaciteteve njerëzore për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi në punë. Vendimi është marrë duke pasur parasysh sezonin e verës dhe fluksin e qytetarëve, me ç'rast qeveria lokale ka arsyetuar se iniciativa në fjalë do të mundësonte ofrimin e shërbimeve pa vonesa, por edhe plotësimin e obligimit ligjor për aprovimin e pushimeve vjetore të punonjësve të përhershëm. Paga mujore për nëpunësit sezonal do të kap vlerën prej 150 euro bruto.

Më kërkesë të Shoqatës së Bashkësisë Hebraike të Kosovës, në Sektorin për Çështje Pronësore Juridike pranë Drejtorisë së Administratës, Bordi ka marrë konkluzionin për dhënien me qira të dy zyrave për nevojat e shoqatës në fjalë, në Ndërtesën e ish-Mbrojtjes Popullore.

Në këtë takim Qeveria komunale ka miratuar edhe kërkesën e Drejtorisë për Shërbime Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për pastrimin e varrezave myslimane, krishtere dhe ortodokse në Prizren, ku ndarja e mjeteve bëhet nga buxheti komunal në kategorinë mallra dhe shërbime.

Ndërsa Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport i është dhënë mbështetja financiare për shënimin e "26 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare kundër substancave narkotike", projekt i paraparë në politikat rinore si komponent i katërt i saj.

Ekzekutivi lokal ka dhënë mbështetje për udhëtim zyrtar në Durrës të Shqipërisë të dy zyrtarëve komunal nga Drejtoria e Administratës në takimin e grupit për identifikimin e nevojave për trajnim, si dhe të dy shërbyesve civil të komunës për udhëtimin zyrtar në Nish të Serbisë për pjesëmarrje në "Rrjetëzimin për Zhvillim Lokal punues" nga Projekti i Komisionit Evropian.

Gjithashtu është miratuar edhe kërkesa e OJQ "EC Ma Ndryshe" që bën monitorimin e ekzekutivit komunal, në lidhje me pjesëmarrjen në takimet e rregullta të kryetarit Muja me bordin këshilldhënës edhe pas skadimit të afatit me Marrëveshjen e Memorandumit, ku monitoruesit do t'i përcjellin vetëm takimet e bordit duke u përjashtuar nga takimet e parabordit.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. "Saraqët" Nr.5 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti "Transparenca online e komunës së Prizrenit" prej muajit shtator 2012 përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.